



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 482/1 Prot.

Tiranë, më 24.1.2018

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për vitin 2017.

Drejtuar: **Znj. Gelardina PRODANI**
NËPUNËS I PARË AUTORIZUES
MINISTRIA E FINANCAVE

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2017, është mbështetur në kërkesat institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, parandalimit dhe goditjes së korrupsionit në sektorin publik e privat, në përputhje me ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si më poshtë vijon;

ILDKPKI, në mbështetje të Ligjit nr.130/2016, datë 15.12.2016, “Për Buxhetin e vitit 2017”, Udhëzimit nr.8, datë 13.1.2017, «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017» i ndryshuar, Aktit Normativ nr.2, datë 16.8.2018 dhe Aktit Normativ nr.3, datë 6.11.2017, “Për disa ndryshime në ligjin nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, i është akorduar një fond buxhetor prej 141 milion e 200 mijë lekë, i cili përbëhet nga:

Fondi i Pagave 101 milion e e 820 mijë lekë (zëri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 15 milion e 880 mijë lekë (zëri 601)
Fondi për Shpenzime Operative: 20 milion e 260 mijë lekë (zëri 602)
Fondi për Investime: 3 milion lekë (zëri 231)
Transferime korrente: 240 mijë lekë (zëri 606)

Buxheti është akorduar për programin “Menaxhim, Administrim, Palanifikim” dhe është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2017-2019.’

Referuar buxhetit të vitit 2017, në respektim të rekomandimeve të dhëna, fondi i planifikuar buxhetor është vënë në funksion të objektivave për forcimin e mëtejshëm të hetimit administrativ, të deklarimit të kontrollit të pasurive dhe për parandalimin dhe zgjidhjen së konfliktit të interesave të personave të zgjedhur, nëpunësve publikë dhe zyrtarëve të tjerë. ILDKPKI në mbështetje të burimeve financiare në dispozicion, realizon objektivat e parashikuara, në funksion rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave private dhe parandalimit të konfliktit të interesit, qëllimit dhe objektivave të cilat lidhen me zbatimin e politikave buxhetore, me qëllimin e realizimit të Misionit të ILDKPKI, në përputhje me objektivat prioritare të institucionit, menaxhimit efektiv të fondeve buxhetore të akorduara për ILDKPKI, duke mundësuar zbatimin efektiv të tyre, në funksion të;

- Deklarimit dhe kontrollit të interesave private nëpërmjet hetimit dhe kërkimeve administrative për vërtetësinë, saktësinë dhe legjitimitetin e burimit të krijimit të pasurive për të zgjedhurit, nëpunësit publik, për familjarët dhe personat e lidhur me ta.
- Garantimit të një vendimmarrje të paanshme, transparente, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave publike dhe atyre private të zyrtarit, në ushtrimin e funksioneve të veta, si dhe arritjen e standardeve ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit.
- Hetimit të rasteve të veprimeve korruptive të paraqitura nga sinjalizuesit, si dhe garantimin e mbrojtjes së tyre nga çdo veprim hakmarrje të ndërmarrë si rrjedhojë e raportimit.
- Bashkëpunimit me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për arritjen e standardeve ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik dhe sanksionimin e masave disiplinore, kundërvajtjeve administrative dhe kallëzimeve penale për zyrtarët dhe personat e lidhur me ta.
- Parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik e privat.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Udhëzimit nr.8, datë 13.1.2017, « Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017 », për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë, ka realizuar vlerën buxhetore në 129,615,9 lekë ose 91.8% të fondit të planifikuar për vitin 2017.

Llog. Ek	Peshkrimi	Plan Buxheti vjetor 2017 I Rishikuar	Plan Buxheti I realizuar VITI 2017	Realizimi % për Vitin 2017
600	Fond Page	101,820.0	97,042.0	95.31%
601	Kontrib. Sig. Shoq. & Shëndetësore	15,880.0	12,925.0	81.39%
602	Shpenzime operative	20,260.0	16,436.5	81.13%
606	Transferime per financime të tjera	240.0	240.0	100.00%
231	Investime	3,000.0	2,972.4	99.08%
	Totali	141,200	129,615.9	91.80%

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë vitit 2017, numëri mesatar i punonjësve është realizuar 69.8 vetë, nga 70 vetë të miratuar.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë, është realizuar për numërin faktik të punonjësve në vlerën 97,041,653 lekë ose 95.31% e fondit të planifikuar për vitin 2017 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 12,925,326 lekë ose 81.39% e planifikimit për periudhën respektive.

Me shkresë nr.6017/2 Prot, datëv 9.5.2017 "*Miratim limiti*" të Ministrisë së Financave, realizohet një shtesë fondi për vitin 2017, në vlerën 10 milion lekë.

Ky fond ka përballuar deri në fund të vitit, efektin financiar të rritjes së pagave në mbështetje të VKM nr.202, datë 15.3.2017, "*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore"* të ndryshuar dhe VKM nr.187, datë 8.3.2017, "*Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë/Nëpunësve, Zëvendesministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të Linjes, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa Institucione të Pavarura, Institucionet në varësi të Kryeministrit, Institucionet në varësi të Ministrive të Linjës dhe Administratën e Prefektit*",

Mosrealizimi i këtij zëri për vitin 2017, ka ardhur dhe si rezultat i kryerjes së procedurave të rekrutimit, në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, gjithsej për 13 vende vakante, në zbatim të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin Civil*", i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në zbatim të tij, për nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive të ulët, të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, të kategorisë të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues, në ILDKPKI.

Fondi për shpenzime në zërin investime (zeri 231),

Gjithsej fondi i planifikuar në zërin investime për vitin 2017, është 3 milion lekë dhe për periudhën respektive, nga fondi i planifikuar është prokuruar vlera prej 3 milion lekë, ose 100% e fondit të planifikuar dhe për vitin është realizuar në vlerën 2,972,388 lekë ose 99 % e fondit të planifikuar vjetor.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi dhe të planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2017, të ndryshuar, për këtë zë shpenzimi ka realizuar për këtë periudhë, fondet e planifikuara të vëna në dispozicion sipas projekteve të miratuara, si më poshtë;

- Fondi i investimeve me objekt "*Blerje pajisje kompjuterike dhe elektronike*", miratuar si produkt nga Ministria e Financave, në vlerën 1,510,000 lekë, është prokuruar me procedurën kërkesë për propozim, fituar nga shoqëria private "BNT ELECTRONICS" Shpk në vlerën 1,427,988 lekë ose 94.5% të fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer në zbatim të detyrimeve të kontratës dypalëshe lidhur më datë 28.4.2018.
- Fondi i investimeve me objekt "*Blerje Pajisje Teknike për Server*", është miratuar si produkt nga Ministria e Financave, në vlerën 1,490,000 lekë me tvsh. Në mbështetje të

Regjistrin të Parashikimeve të Prokurimeve Publike, kjo vlerë është prokuruar me procedurën kërkesë për propozim, fituar nga shoqëria private "SINAPSE" sh.p.k, në vlerën 1,370,400 lekë ose 91% të fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer në zbatim të detyrimeve të kontratës dypalëshe lidhur më datë 31.7.2017.

- Fondi i investimeve me objekt "Blerje Paisje zyre të tjera", miratuar si produkt nga Ministria e Financave, nga kursimet e krijuara gjatë procesit të prokurimit të projekteve të sipërcituara, është prokuruar në vlerën 201,612 lekë me tvsh, me procedurën blerje e vogël me vlerë fituese 174,000 lekë, dhe është likujduar tërësisht sipas specifikimeve teknike.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zeri 602),

Për periudhën respektive, për këtë zë të shpenzimeve, është realizuar gjithsej vlera prej 16,436,527.1 lekë ose 81.13% e fondit të planifikuar vjetor, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

- Shërbimi me objekt "Ruajtja dhe sigurimi i godinës së ILDKPKI me roje objekti 24 orë" është realizuar me procedurën e kërkesës për propozim dhe është fituar nga firma private "International Security Albania" sh.p.k, në vlerën 2,398,108 (Dy milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tetë) lekë me tvsh, ose 79.9% e fondit limit të parashikuar Në mbështetje të kontratës së lidhur ndërmjet ILDKPKI dhe operatorit ekonomik "International Security Albania" sh.p.k., në nenin 17, "Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve" është lidhur Amendim Kontrate në zbatim të nenit 850 e vijues të Kodit Civil, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, ligjit nr. 75/2014, "Për shërbimin privatë të sigurisë fizike" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 399, datë 02.05.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" në vlerën 165,615.8 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë pik 8*) lekë me tvsh. Likujdimi është kryer në zbatim të kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, nr.1148 Prot, datë 24.3.2017.
- Fondi i parashikuar për grup artikullin "Blerje Bojra Printeri dhe Fotokopje" për ILDKPKI, me fond limit për 2 milion lekë, është realizuar me procedurën e kërkesës për propozim dhe është fituar nga firma privatme "Infosoft Office" sh.p.k në vlerën 1,885,200 lekë me tvsh ose 94.3% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer në zbatim të kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, nr.2585 Prot, datë 29.5.2017.
- Fondi i parashikuar për grup artikullin "Mirëmbajtje dhe riparime, pjesë këmbimi për 3 automjete" është prokuruar me procedurën blerje me vlerë të vogël dhe është fituar nga firma private "Kombinat Servis" sh.p.k, në vlerën 346,680 lekë me tvsh. Likujdimi është kryer në vlerën 246,720 lekë, në mbështetje të kërkesave të ILDKPKI dhe kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, nr.1539 Prot, datë 19.04.2017, sipas dispozitave në fuqi.
- Fondi i parashikuar për grup artikullin "Blerje materiale kancelarie", me fond limit për 1 milion lekë, është realizuar me procedurën e kërkesës për propozim dhe është fituar nga firma privatme "Infosoft Office" sh.p.k në vlerën 818,001.24 lekë me tvsh ose 81% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer në zbatim të detyrimeve dhe kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, nr.2744 Prot, datë 2.6.2017.

Përsa i përket shpenzimeve për blerje mallra të natyrave të ndryshme, institucioni ynë për këtë periudhë, i ka prokuruar dhe realizuar sipas nevojave konkrete, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

Gjatë periudhës respektive, shpenzimet në zërin shërbime të ndryshme janë realizuar në përmbushjen e detyrimeve me shtetin si posta, energji, ujë, telefoni. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë lidhur kontrata shpenzim i abonimit në shtyp, siguracione të detyrueshme për automjetet e ILDKPKI, kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, gjeneratorit e tj. të cilat institucioni ynë, i ka likujduar, në mbështetje të specifikimeve teknike të sanksionuara në mareveshjet dypalëshe.

Realizimi i të ardhurave nga veprimtaria e ILDKPKI.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI, vijnë kryesisht nga:

- 1) Arkëtimi i gjobave të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të ligjit nr.nr.9049, datë 10.4.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar si dhe nga zbatimi i ligjit nr.60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, nga njësitë përgjegjëse në autoriteteve publike dhe subjektet private. Për vitin 2017, janë gjithsej 186 raste, në vlerën 29,160,164 lekë.
- 2) Ekzekutimi i detyrueshëm nga Zyrat Përmbarimore të Rretheve, për gjobat e vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, si dhe vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë.
Për vitin 2017, janë ekzekutuar tërësisht gjithsej 112 raste, në vlerën 18,625,000 lekë, nga të cilat 84 raste në vlerën 14,425,000 lekë, kanë kaluar në llogari të të ardhurave të ILDKPKI. Arkëtimi në favor të ILDKPKI, për 28 raste të tjera, të cilat përbëjnë vlerën 4,200,000 lekë, është në proces likujdimi.
- 3) Të ardhura të tjera të cilat për periudhën respektive, janë në vlerën 67,800 lekë.

Gjithsej të ardhurat të arkëtuara për vitin 2017, janë në vlerën 43,652,964 lekë.

Të gjitha këto të ardhura, të realizuara në zbatim të ligjeve organike mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë dhe të VKM nr.432 dt.28.06.2006 “Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore”, kalojnë në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

ILDKPKI, për periudhën në vazhdim në mbështetje të kërkesave në rritje, për përmirësim e mëtejshëm të punës në zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara, do të zbatojë me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji për deklarimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave private të zyrtareve, si dhe legjislacionin financiar në fuqi.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Kozeta NDOI



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2017

Shtojca Nr.7: Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve Buxhetorë

ne 000 leke

Institucioni	Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit			Kodi i Grupit 76
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim		Totali I Shpenzimeve	
Artikulli	Emri	Buxheti	Fakti	Diferenca
kodi		Perfundimtar	VITI 2017	2017
		2017		
600	Paga	101,820	97,042.00	4,778.00
601	Sigurime Shoqërore	15,880	12,925.00	2,955.00
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	20,260	16,436.50	3,823.50
603	Subvencione			-
604	Transferta Korente të Brendshme			-
605	Transferta Korente të Huaja			-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	240.00	240.00	-
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	138,200.00	126,643.50	11,556.50
230	Kapitale të Patrupëzuara			-
231	Kapitale të Trupëzuara	3,000.00	2,972.40	27.60
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale	3,000.00	2,972.40	27.60
				-
Totali	Korrente dhe Kapitale	141,200.00	129,615.90	11,584.10
Jashte Buxhetore		0.0	0.0	-
Totali (korrente + kapitale + jashte buxhetore)		141,200.00	129,615.90	11,584.10

Sekretari i	Emri:	Kozeta NDOI	
Pergjithshem	Nenshkrimi		
	Data		24.1.2018

Raportet e Monitorimit

Buxheti 2017

Shtojca Nr.8: Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve

ne 000 leke

Institucioni	Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit					Kodi i Grupit 76
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim		Totali I Shpenzimeve			
Programi		PBA PLAN 2017	Buxhet Rishikuar 2017	Buxheti Perfundimtar 2017	Fakti 12- MUJORI 2017	Diferenca 2017
Titulli	Emri					
01110	Planifikim, Menaxhim ,Administrim	129,500.00	141,200.00	141,200.00	129,615.90	11,584.10
Totali	Shpenzime të miratuara	129,500.00	141,200.00	141,200.00	129,615.90	11,584.10

Sekretari i Pergjithshem	Emri:	Kozeta NDOI
	Nenshkrimi	
	Data	24.1.2018




Raportet e Monitorimit

Buxheti 2017

Shtojca Nr.9 Raporti i Realizimit të Rezultateve të Programit

ne 000 leke

Institucioni	Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit				Kodi i Grupi	76		
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim		Titulli	01110				
Kodi		Njesi	Sasia	Sasia	Realizimi			
Rezultatit	Emri I Rezultatit	Matese	e Planifikuar	Prokuruar gjithsej viti 2017	Plotesisht	Pjeserisht	Aspak	Komente
M760024	Blerje Paisje Kompjuterike dhe Elektronike	000/leke	1,427,988	1,427,988.0	1,427,988			perfunduar
M760041	Blerje Paisje teknike për dhomën e serverit	000/leke	1,370,400	1,370,400.0	1,370,400			perfunduar
M760030	Paisje zyre të tjera	000/leke	201,612	201,612.0	174,000			perfunduar
	Totali (kapitale)		3,000,000.0	3,000,000.0	2,972,388.0			

Sekretari i	Emri:	Kozeta NDOI
Pergjithshem	Nenshkrimi	
	Data:	24.1.2018




Raportet e Monitorimit

Buxheti 2017

Shtojca Nr.10: Raporti I i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Rezultateve

Institucioni								
Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit							Kodi i Grupit	76
Programi								
Planifikim, Menaxhim ,Administrim				Titulli		01110		
Kodi	Emri I Rezultatit	Shpenzimet e Rezultatit				Kosto per njesi 000/leke		
		PBA Plan 2017	Pl.Buxheti Fillestar 2017	Pl.Buxheti Rishikuar 2017	Fakti 2017 12-M i prokuruar	Kosto per njesi Plan 2017	Kosto per njesi Fakt 2017	Shpjegime
M760024	Blerje Paisje Kompjuterike dhe Elektronike	1,510.0	1,510.0	1,428.0	1,427,988	68.64	64.90	likujduar
M760041	Blerje Paisje teknike për dhomën e serverit	1,490.0	1,490.0	1,370.4	1,370,400	106.40	98.86	likujduar
M760030	Paisje zyre të tjera			201.6	174,000	50.40	43.50	likujduar
Totali (kapitale)		3,000.0	3,000.0	3,000.0	2,972,388.00			

Sekretari i	Emri:	Kozeta NDOI
Pergjithshem	Nenshkrimi	
	Data:	24.1.2018

